

RAPORT

mbi financimin e projekteve
dhe programeve të OJQ-ve
nga fonde të ndryshme të
dedikuara
për vitin **2024.**

BOTUES:
Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare
(CRNVO)
rr. Sima Barovića 24, Podgoricë
Tel/fax: 020/219 120, 219 121, 219 122, 219 123
E-mail: crnvo@crnvo.me www.crnvo.me

Titulli i publikimit:
HULUMTIM PËR PJESËMARRJEN E OJQ-ve
NË HARTIMIN E POLITIKAVE PUBLIKE
NË v. 2024

PËR BOTUESIN:
Zorana Marković

AUTORËT:
Filip Vicković
Nazif Veliq
Zdravko Janjušević
Marina Vuksanović
Milan Medenica
Kenan Keçević
Zorana Marković

BASHKËPUNTORËT NË HULUMTIM:
Milosh Marković
Aleksa Minić
Hazreta Cuca

PËRGATITJA dhe DIZAJNI
New Page D.O.O.
Podgoricë, korrik 2025.

Raporti u përgatit në kuadër të projektit “Rrjeti i qendrave burmiore të Malit të Zi”. Pikpamjet dhe përfundimet e paraqitura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal-Investues dhe bashkëpunimit me organizatat joqeveritare.

HYRJE

Financimi nga buxheti i punës së organizatave joqeveritare (OJQ) luan një rol të rëndësishëm në forcimin e proceseve demokratike dhe në përmirësimin e politikave publike. Përmes mbështetjes nga fondet publike, OJQ-të fitojnë mundësinë që të zbatojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme aktivitete me interes të përgjithshëm, si mbrojtja e të drejtave të njeriut, përfshirja sociale, arsimi, kultura dhe mbrojtja e mjedisit. Në këtë mënyrë, zgjerohet kapaciteti i shoqërisë për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve, të cilat institucionet shtetërore shpesh nuk mund t'i mbulojnë të vetme. Financimi nga buxheti kontribuon gjithashtu në profesionalizimin e punës së organizatave joqeveritare. Burimet e qëndrueshme financiare mundësojnë punësimin e stafit profesional, planifikimin afatgjatë të projekteve dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale. Kështu, OJQ-të bëhen partnerë më të besueshëm të organeve shtetërore dhe të vetëqeverisjeve lokale në zbatimin e politikave publike, por njëkohësisht edhe një mekanizëm i rëndësishëm mbikëqyrës i pushtetit, përmes monitorimit, analizës dhe avokimit publik. Një rëndësi e veçantë e financimit nga buxheti reflektohet në forcimin e demokracisë pjesëmarrëse. Organizatat joqeveritare shpesh veprojnë si ndërmjetëse mes qytetarëve dhe institucioneve, artikulojnë nevojat e grupeve të ndryshme shoqërore dhe nxisin pjesëmarrjen aktive në proceset e vendimmarrjes. Kur puna e tyre financohet nga fondet publike, mbi bazën e kriterëve të qarta dhe procedurave transparente, rritet besimi i publikut dhe sigurohet që fondet të orientohen drejt projekteve që kanë ndikim real shoqëror.

Njëkohësisht, është e rëndësishme që financimi nga buxheti të shoqërohet me mekanizma përgjegjshmërie dhe kontrolli, në mënyrë që të ruhet pavarësia e sektorit joqeveritar dhe të parandalohen keqpërdorimet. Rregullat e qarta për ndarjen e fondeve, monitorimi, raportimi transparent dhe vlerësimi i rezultateve mundësojnë arritjen e një ekuilibri ndërmjet mbështetjes shtetërore dhe autonomisë së shoqërisë civile, duke kontribuar kështu në zhvillimin afatgjatë të shoqërisë në tërësi. Përveç linjave të veçanta buxhetore të dedikuara për organizatat joqeveritare, është me rëndësi thelbësore që OJQ-të të zhvillojnë konkurrueshmërinë dhe aftësinë për të aplikuar në mënyrë të barabartë për fonde që nuk janë të destinuara ekskluzivisht për sektorin joqeveritar. Në fusha të tilla si bashkëfinancimi i veprimtarisë kulturore dhe artistike, zhvillimi i turizmit, ruajtja dhe promovimi e trashëgimisë kulturore, zhvillimi ekonomik lokal dhe fusha të tjera, organizatat joqeveritare shpesh disponojnë njohuri, kreativitet dhe lidhje të drejtpërdrejta me komunitetin lokal, gjë që u jep atyre një avantazh krahasues. Pjesëmarrja në këto konkurse nxit rritjen e cilësisë së programeve, bashkëpunimin ndërsektorial dhe qasjet inovative, ndërsa në të njëjtën kohë kontribuon në qëndrueshmërinë financiare të organizatave dhe integrimin e tyre në proceset më të gjera të zhvillimit shoqëror.

Ky raport analizon pikërisht financimin e punës së organizatave joqeveritare nga Buxheti i Malit të Zi, i cili nuk ndahet në përputhje me Ligjin për Organizatat Joqeveritare^[1] dhe as në përputhje me vendimet e njësive të vetëqeverisjes lokale të miratuara në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale^[2]. Pikërisht për këtë arsye, dhe me qëllim sigurimin e një pasqyre më të qartë mbi burimet e financimit, mënyrat e shpërndarjes së fondeve dhe rezultatet e financimit të projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare në Mal të Zi gjatë vitit 2024, është realizuar një hulumtim i bazuar në analizë të thelluar të legjislacionit dhe të raporteve të disponueshme publikisht. Të dhënat janë mbledhur në kuadër të programit "Rrjeti i Qendrave Burimore në Mal të Zi", të cilin, me mbështetjen e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal-Investues dhe Bashkëpunimit me Organizatat Joqeveritare, e zbatojnë Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare (CRNVO) si qendër kombëtare burimore, qendrat rajonale burimore OJQ "Bjelopoljski demokratski centar", OJQ "Aktivna zona" dhe OJQ "Horizonti i Ri", si dhe zyrat lokale të OJQ "Bonum", OJQ "Natura" dhe OJQ "Nada".

^[1] Ligji për organizatat joqeveritare („Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 39/2011 dhe 37/2017).

^[2] Ligji për vetëqeverisjen lokale („Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 2/2018, 34/2019 dhe 38/2020).

Financimi nga Buxheti i Malit të Zi – çfarë është e dedikuar ekskluzivisht për OJQ-të?

Kur flasim për Buxhetin e Malit të Zi, Ligji për Organizatat Joqeveritare, si dhe Rregullorja për financimin e projekteve dhe programeve të organizatave joqeveritare në fushat me interes publik[3], përcaktojnë mënyrën e ndarjes së mjeteve financiare për financimin e projekteve dhe programeve të organizatave joqeveritare. Ky financim është i dedikuar ekskluzivisht për organizatat joqeveritare dhe, me qëllim mbrojtjen e integritetit dhe qëndrueshmërisë së tyre, është përcaktuar në një shumë minimale prej 0,5% të buxhetit të përgjithshëm shtetëror, nga e cila 0,1% është e destinuar për bashkëfinancimin e projekteve që financohen nga fondet e Bashkimit Evropian, ndërsa 0,1% për projektet që synojnë ofrimin e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara. Kjo dispozitë mbrojtëse u garanton organizatave joqeveritare siguri ndaj vendimeve të motivuara politikisht të Qeverisë për t'ua mohuar këto mjete me qëllim vështirësimin e punës së tyre dhe, në fund, heshtjen e zërave kritikë të shoqërisë civile. Në ciklin e ndarjes së fondeve në përputhje me Ligjin për OJQ-të, dallohen fazat në vijim: planifikimi, formimi i komisionit për ndarjen e mjeteve, shpallja e konkursit, përzgjedhja e përfituesve, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi.

Në fazën e parë, përkatësisht në fazën e planifikimit, ministritë zhvillojnë një analizë sektoriale, përkatësisht procesin e vlerësimit të fushave që janë në kompetencën e tyre dhe në të cilat do të mbështeten projektet e organizatave joqeveritare. Ky proces mbështetet në legjislacionin në fuqi, strategjitë, programet, planet e veprimit dhe politikat e tjera publike që përcaktojnë drejtimit e punës së pushtetit ekzekutiv. Pas hartimit të draftit të analizës sektoriale, ai duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, gjatë të cilit organizatat joqeveritare kanë mundësinë të kontribuojnë në përmbajtjen e analizës. Ky kontribut ndikon drejtpërdrejt në tekstin përfundimtar të konkursit dhe, rrjedhimisht, edhe në projektet që do të mbështeten. Analiza sektoriale hartohet gjatë vitit aktual për vitin pasardhës.

Pas përfundimit të kësaj faze, vazhdohet me formimin e Komisionit për ndarjen e mjeteve, i cili përbëhet nga dy përfaqësues të ministrisë përkatëse dhe, përmes një thirrjeje publike, mund të përfshijë edhe një përfaqësues të organizatave joqeveritare. Përfaqësuesi i OJQ-ve zgjidhet në përputhje me Rregulloren për zgjedhjen e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare në trupat punues të organeve të administratës shtetërore dhe për zhvillimin e konsultimeve publike gjatë përgatitjes së ligjeve dhe strategjive [4].

Detyrat e Komisionit janë shpallja e konkursit, verifikimi administrativ i aplikimeve të pranuar, angazhimi i vlerësuesve të pavarur, konsolidimi i listës së renditjes së projekteve, si dhe monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të tyre.

Komisioni shpall konkursin për financimin e projekteve dhe programeve të organizatave joqeveritare në fushat e përcaktuara përmes analizës sektoriale. Konkursi qëndron i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes, ndërsa afati për përzgjedhjen e projekteve që do të financohen nuk është i përcaktuar. Pas miratimit të vendimit për ndarjen e fondeve, nënshkruhen kontratat me përfituesit dhe vijon faza e zbatimit të projekteve, e cila përfshin raportim periodik dhe përfundimtar, si për aspektin financiar, ashtu edhe për atë narrativ të realizimit të projektit ose programit.

[3] Rregullorja për financimin e projekteve dhe programeve të organizatave joqeveritare në fushat me interes publik („Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 13/2018).

[4] Rregullorja për përzgjedhjen e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare në organet punuese të organeve të administratës shtetërore dhe zhvillimin e konsultimit publik gjatë përgatitjes së ligjeve dhe strategjive („Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 041/18, datë 28.06.2018).



Në fund, Komisioni është i detyruar të kryejë monitorimin gjatë zbatimit të projektit, si dhe vlerësimin pas përfundimit të zbatimit të tij, me qëllim që të vlerësojë cilësinë e realizimit të aktiviteteve dhe nivelin e arritjes së rezultateve dhe objektivave të projektit. Në nivel lokal, njësitë e vetëqeverisjes lokale, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, mund të zhvillojnë bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë civile në nivel lokal përmes financimit të projekteve dhe programeve të OJQ-ve. Ky proces rregullohet me vendimet e miratuara nga Kuvendet e Komunave, prandaj nuk ekziston një praktikë e unifikuar në këtë drejtim. Varësisht nga mundësitë dhe kapacitetet e tyre, njësitë e vetëqeverisjes lokale miratojnë vendime të përshtatura me kontekstin dhe nevojat lokale. Ka pasur disa përpjekje për të promovuar dhe për të futur praktika moderne të ndarjes së fondeve, të cilat do të përfshinin formimin e komisioneve, angazhimin e vlerësuesve të pavarur, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve. Ndër organizatat që kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në avokimin për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së ndarjes së fondeve për OJQ-të në nivel lokal dallohen Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare (CRNVO) dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) përmes projektit ReLOaD. Megjithatë, ende nuk ekziston një sistem i harmonizuar për ndarjen e fondeve në nivel lokal, ndërsa disa njësi të vetëqeverisjes lokale vazhdojnë të mos e zbatojnë fare këtë proces.

Përveç mjeteve të rezervuara për OJQ-të

Përveç mjeteve që janë të përcaktuara në mënyrë të qartë për organizatat joqeveritare në përputhje me Ligjin për Organizatat Joqeveritare, OJQ-të në Mal të Zi mund të aplikojnë edhe në një sërë konkurseve të tjera që shpallen nga organe të ndryshme të administratës shtetërore dhe institucione të tjera ushtruese të autorizimeve publike. Organizatat joqeveritare gjithashtu mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik që financohen nga buxheti, nëse ushtrojnë veprimtari ekonomike, si dhe mund të jenë përfituese të ndihmës së minimis, të akorduar nga Qeveria e Malit të Zi ose nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, mbi bazën e të drejtës diskrecionale. Ky hulumtim analizon fondet që janë të disponueshme për organizatat joqeveritare përmes konkurseve publike, duke pasur parasysh se këto përfaqësojnë një procedurë të organizuar dhe të rregulluar nga legjislacioni material në fuqi. Ndër konkurset për ndarjen e fondeve publike, të cilat nuk bëjnë pjesë në kategorinë e fondeve të ndara në bazë të Ligjit për Organizatat Joqeveritare ose Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, mund të dallohen dy kategori:

- konkurset që janë të dedikuara ekskluzivisht për organizatat joqeveritare; dhe
- konkurset që janë të hapura për kategori të ndryshme të personave juridikë, por në të cilat organizatat joqeveritare plotësojnë kushtet për të aplikuar dhe, në praktikë, aplikojnë rregullisht.

Në kategorinë e parë, gjatë vitit 2024 bënë pjesë vetëm Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit (Eko Fond), përkatësisht Konkursi Publik për ndarjen e mjeteve të pakthyeshme (subvencioneve) për projektet e mbrojtjes, ruajtjes dhe përmirësimit të mjedisit për organizatat joqeveritare, i shpallur më 18 korrik 2024. Ky konkurs përbën një nga konkurset që Eko Fondi shpall çdo vit, ndërsa konkurset e tjera kanë të bëjnë me: përshtatjen e objekteve për rritjen e efikasitetit energjetike, mbështetjen e ndërmarrjeve komunale lokale në menaxhimin e mbeturinave, rregullimin e hapësirave publike, kalimin në burime të ripërtëritshme të energjisë etj. Megjithatë organizatat joqeveritare, në praktikë, mund të aplikojnë edhe për forma të tjera mbështetjeje, si p.sh. subvencionet për përshtatjen e zyrave të tyre, konkursi për ndarjen e mjeteve të pakthyeshme për projektet e OJQ-ve mbetet forma e vetme e zakonshme e mbështetjes që u dedikohet posaçërisht organizatave joqeveritare.

Ashtu si edhe për konkurset e tjera, Eko Fondi ka vendosur rregulla të unifikuara që zbatohen për të gjitha konkurset, përmes Rregullores për kushtet që duhet të plotësojnë përfituesit, mënyrën e ndarjes dhe përdorimit të mjeteve të Fondit për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe Rregullores për mënyrën e monitorimit të përdorimit të dedikuar të mjeteve të Fondit për Mbrojtjen e Mjedisit.[5]

Këto rregullore përcaktojnë se kush mund të aplikojë në konkurs, kushtet që duhet të plotësohen, mënyrën e shpalljes së konkurseve, formimin e komisionit për vlerësimin e aplikimeve, përmbajtjen e aplikimit, si dhe elemente të tjera të rëndësishme për zhvillimin e procedurës. Këto rregulla e bëjnë këtë konkurs të ngjashëm me konkurset e tjera që shpallen nga organet e administratës shtetërore.

Gjatë vitit 2024, në bazë të Konkursit Publik për ndarjen e mjeteve të pakthyeshme për projektet e OJQ-ve, Eko Fondi miratoi tre vendime për përzgjedhjen e përfituesve dhe ndarjen e mjeteve financiare, si më poshtë:

OJQ "Qendra për Ndryshimet Klimatike, Burimet Natyrore dhe Energjinë" – 19.541 euro;

OJQ "Aleanca Qytetare" – 19.550 euro;

Klubi i Zhytjes "Tim Ajkula" – 19.550 euro.

Në total u ndanë 58.641 euro.

Pas vlerësimit të projekteve të paraqitura, ato u renditën sipas pikëve të fituara, ndërsa rezultatet e vlerësimit janë publikuar në listën e renditjes së përfituesve të mjeteve, si dhe në vetë vendimet për përzgjedhjen e përfituesve dhe ndarjen e fondeve. Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë një sërë konkurseve të shpallura nga institucione të ndryshme, në të cilat mund të aplikojnë jo vetëm organizatat joqeveritare, por edhe persona të tjerë fizikë dhe juridikë, në përputhje me kushtet e secilit konkurs. Këtu përfshihen konkurset e Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, Ministrisë së Turizmit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Organizatave Turistike dhe Entit për Punësim. Shuma më e madhe e mjeteve të ndara për organizatat joqeveritare në kuadër të këtyre konkurseve është akorduar përmes konkursit të Entit për Punësim, për zbatimin e programit "Hapja e Drejtpërdrejtë e Vendeve të Punës – Punë Publike" për vitin 2024. Në kuadër të këtij programi, organizatave joqeveritare u janë ndarë 733.399,37 euro, nga gjithsej 999.803,20 euro të ndara në këtë konkurs.

Përveç organizatave joqeveritare, ndër përfituesit figurojnë kryesisht institucione publike, komuna, organe të administratës lokale, si dhe një numër më i vogël ndërmarrjesh publike dhe private.

Këto mjete janë ndarë përmes dy linjave të financimit: për realizimin e programeve me karakter social; dhe për realizimin e programeve me karakter humanitar, edukativ, ekologjik, komunal, infrastrukturor, për ruajtjen e monumenteve kulturore dhe historike, si dhe aktiviteteve të tjera në fusha me interes publik. Përmes linjës së parë janë ndarë 501.605,81 euro për 77 programe të organizatave joqeveritare (nga gjithsej 90 programe të financuara në këtë linjë), në kuadër të të cilave janë punësuar 220 persona (nga gjithsej 267 persona të punësuar në këtë linjë).

Përmes linjës së dytë janë ndarë 231.793,56 euro për 58 organizata joqeveritare (nga gjithsej 102 aplikantë në këtë linjë), ndërsa në kuadër të këtyre programeve janë punësuar 143 persona, nga gjithsej 256 persona të punësuar në këtë linjë.

[5] Akti i brendshëm i Fondit Eko, i disponueshëm në: [5\] Interni akti Eko-fonda, dostupni na: https://www.eko-fond.co.me/regulativa](https://www.eko-fond.co.me/regulativa)

Pas Entit për Punësim, sipas shumës së mjeteve të ndara, renditet Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, i cili në kuadër të konkursit të tij ndau 503.000 euro për 45 projekte të organizatave joqeveritare, nga gjithsej 1.591.125 euro të shpërndara për 221 projekte. Përveç organizatave joqeveritare, në listën e përfituesve figurojnë kryesisht persona fizikë, si dhe një numër i vogël shoqëri tregtare dhe mediash.

Një nga fondet që gjatë vitit 2024 ndau mjete financiare për përfitues të ndryshëm, ndër të cilët edhe organizata joqeveritare, ishte Fondi për Inovacione. Gjatë vitit 2024, Fondi për Inovacione mbështeti gjithsej 71 projekte, me një vlerë totale prej 3.246.800,32 euro, në kuadër të shtatë konkurseve. Megjithatë, organizatat joqeveritare kishin të drejtë të aplikojnë vetëm në dy linja financimi:

- Linja 5 – Nxitja e kulturës së inovacionit; dhe
- Linja 6 – Zbatimi i programeve edukative në fushën e specializimit inteligjent.

Programet e tjera ishin të orientuara drejt mbështetjes së start-up-eve, shoqërive tregtare, personave fizikë – inovatorë, institucioneve kërkimore dhe arsimore, si dhe subjekteve të tjera.

Në kuadër të Linjës 5 – Nxitja e kulturës së inovacionit, u ndanë gjithsej 84.197,15 euro për 11 projekte, prej të cilave 7 projekte u propozuan nga organizatat joqeveritare, me një vlerë totale grantesh prej 52.548 euro.

Në kuadër të Linjës 6 – Zbatimi i programeve edukative në fushën e specializimit inteligjent, u ndanë gjithsej 150.000 euro për 17 grante. Prej tyre, 8 projekte, me një vlerë të përgjithshme prej 77.000 euro, u zbatuan nga organizatat joqeveritare.

Në total, gjatë vitit 2024, organizatat joqeveritare përfituan 161.197,15 euro nga Fondi për Inovacione.



Përveç kësaj, organizatave joqeveritare u janë ndarë mjete financiare edhe nga Ministria e Turizmit, në kuadër të konkursit për mbështetjen e projekteve në fushën e turizmit për vitin 2024, përmes Masës I – Mbështetje për organizimin e manifestimeve/festivaleve dhe Masës III – Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të qëndrueshme turistike që pasurojnë ofertën turistike në fushën e turizmit kulturor, sportiv-rekreativ dhe aventuristik.

Në kuadër të konkursit të parë, u ndanë 45.279,85 euro për bashkëfinancimin e 11 manifestimeve të organizuara nga organizatat joqeveritare, nga gjithsej 178.065,70 euro të ndara për 34 manifestime. Përveç organizatave joqeveritare, ndër aplikantët figurojnë kryesisht institucione publike dhe shoqëri tregtare.

Në kuadër të linjës së dytë, organizatave joqeveritare u janë ndarë 27.600 euro për bashkëfinancimin e 8 projekteve, nga gjithsej 100.000 euro të ndara për 19 projekte. Përveç organizatave joqeveritare, në këtë konkurs kanë aplikuar kryesisht organizata turistike dhe shoqëri tregtare. Në total, gjatë vitit 2024, Ministria e Turizmit u ka ndarë organizatave joqeveritare 72.879,85 euro në kuadër të këtij mekanizmi të financimit.


Në vitin 2024, Ministria e Punëve të Brendshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen dhe Shpëtimin, zhvilloi konkursin për ndarjen e mjeteve nga Fondi për Mbrojtje dhe Shpëtim, përfitues të të cilit mund të jenë organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, organet e administratës lokale, shoqëritë tregtare, persona të tjerë juridikë dhe sipërmarrës, njësitë operative, organizatat joqeveritare dhe qytetarët me seli, përkatësisht vendbanim, në Mal të Zi.

Në kuadër të këtij konkursi, një organizate joqeveritare iu nda një grant në vlerë prej 13.750 euro, nga gjithsej 123.752,88 euro të shpërndara për 9 projekte, përfituesit e të cilave ishin kryesisht njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe njësitë e tyre organizative.

Përveç organeve dhe fondeve në nivel shtetëror, edhe Organizatat Lokale Turistike kanë ndarë mjete financiare për organizatat joqeveritare. Gjatë vitit 2024, këtë e bëri Organizata Turistike e Tivatit, përmes Thirrjes Publike për pjesëmarrje në procedurën e ndarjes së mjeteve për përzgjedhjen e projekteve për valorizimin e trashëgimisë kulturore, që kanë të bëjnë me hulumtimet arkeologjike, punimet konservuese dhe restauruese, rindërtimin dhe promovimin e pasurive kulturore në territorin e Komunës së Tivatit.

Në kuadër të kësaj thirrjeje, organizatave joqeveritare iu ndanë 25.404 euro për dy projekte të plota dhe për dy segmente të një projekti, të financuara nga mjetet e mbetura. Në total, në kuadër të këtij konkursi u shpërndanë 64.067,34 euro për 4 projekte dhe 4 segmente projektsh, të financuara nga fondet e mbetura.

Raportet e shumave nga programet e përmendura të ndajrjes së fondeve



Nëse e shohim në tërësi, gjatë vitit 2024 organizatave joqeveritare u janë shpërndarë gjithsej 1.568.271,37 euro përmes mekanizmave të përmendur. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve është shpërndarë nga Enti për Punësim, në vlerë prej 733.399,37 euro, që përbën 47% të shumës totale. Në vendin e dytë renditet Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, me 503.000 euro, ose 32% të shumës së përgjithshme.

Fondi për Inovacione u ka shpërndarë organizatave joqeveritare 161.197,15 euro, që përfaqësojnë 10% të shumës totale të ndarë në vitin 2024. Shuma më të vogla janë ndarë nga Ministria e Turizmit (72.879,85 euro – 5%), Eko Fondi (58.641 euro – 4%), Organizata Turistike e Tivatit (25.404 euro – 2%) dhe Ministria e Punëve të Brendshme (13.750 euro – 1%).

Emri i organit	Totali i shpërndarë	Shpërndarë për OJQ-të	Në përqindje
Enti i Punësimit	999 803.2	733 399.4	73%
Fondi për Pakicat	159 1125	503 000	32%
Fondi për inovacion	234 197.2	161 197.2	69%
Ministria e turizmit	278 065.7	72 879.85	26%
Fondi Eko	58 641	58 641	100%*
Ministria e Punëve të Brendshme	123 752.9	13 750	11%
TO Tivat	64 067.34	25 404	40%
GJITHSEJ	3 349 652.34	1 568 271.45	47%

* Konkursi i Fondit Eko ishte i dedikuar ekskluzivisht për OJQ-të.

Si janë procedurat?

Në mekanizmat e përshkruar të shpërndarjes, ndryshe nga sistemi i krijuar me Ligjin për organizatat joqeveritare, nuk ekziston një mënyrë unike e planifikimit të fondeve, por secili organ miraton rregullat e veta në përputhje me legjislacionin material, të cilat zbatohen për të gjithë aplikantët.

Kështu, për shembull, Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit ka miratuar Rregulloren për kushtet që duhet të plotësojnë përfituesit, mënyrën e ndarjes dhe përdorimit të mjeteve të Fondit për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe Rregulloren për mënyrën e monitorimit të përdorimit të dedikuar të mjeteve të Fondit për Mbrojtjen e Mjedisit, me qëllim rregullimin e shpërndarjes së fondeve.

Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave udhëhiqet nga Rregullorja për mënyrën e vlerësimit të projekteve që financohen nga mjetet e Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave[6].

Fondi për Inovacionin, në vitin 2023, ka miratuar Rregulloren për procesin e vlerësimit, cilësia e së cilës konfirmohet edhe nga akreditimi i Programit të granteve bashkëpunuese për inovacion për skemën EIC Plug-in, të zbatuar nga Këshilli Evropian i Inovacionit (EIC).

Ministria e Administratës Publike zhvillon konkursin e saj për ndarjen e mjeteve nga fondi për mbrojtje dhe shpëtim duke përdorur rregullat e përcaktuara përmes Ligjit për mbrojtjen dhe shpëtimin[7].

Procedurat për ndarjen e mjeteve përmes thirrjeve publike të zhvilluara nga organizatat lokale turistike, si Organizata Turistike e Tivatit, nuk janë të përcaktuara, ndërsa baza ligjore për zbatimin e tyre gjendet në Ligjin për taksën e qëndrimit.

Për Ministrinë e Turizmit, përkatësisht për konkurset publike për masën I – mbështetje për organizimin e manifestimeve/festivaleve, dhe masën III – zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të qëndrueshme turistike që pasurojnë ofertën turistike në turizmin kulturor, sportiv-rekreativ dhe aventurier, baza ligjore përbëhet nga Konkluzioni i Qeverisë së Malit të Zi nr. 08-330/24-3704/2, përkatësisht Programi i masave nxitëse në fushën e turizmit për vitin 2024, i cili është miratuar me këtë konkluzion, dhe kjo në bazë të Ligjit për turizmin dhe hotelerinë[8].

Enti i Punësimit i Malit të Zi zhvillon konkursin e tij për zbatimin e Programit „Hapja e drejtpërdrejtë e vendeve të punës – punë publike” në bazë të Ligjit për ndërmjetësimin në punësim dhe të drejtat gjatë kohës së papunësisë[9].

[6] Rregullorja për mënyrën e vlerësimit të projekteve që financohen nga mjetet e Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave („Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 064/18, datë 04.10.2018).

[7] Ligji për mbrojtjen dhe shpëtimin („Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 13/07, 32/11, 54/16, 146/21 dhe 3/23).

[8] Ligji për turizmin dhe hotelerinë („Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 2/2018, 4/2018 – korrigjim, 13/2018, 25/2019, 67/2019 – ligj tjetër dhe 76/2020).

[9] Ligji për ndërmjetësimin në punësim dhe të drejtat gjatë kohës së papunësisë („Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 24/2019 dhe 29/2025).

Naziv organa	Pjesëmarrja e publikut në përcaktimin e prioriteteve	Detyrimi për krijimin e komisionit	Afati për korrigjimin e parregullsive	Vlerësimi i jashtëm	Listat e renditjes	Monitoring	Evaluumi
Enti për punësim	Jo	Po	Po	Jo	Po	Jo	Jo
Fondi për inovacion	Jo	Po	Jo	Po	Po	Jo	Jo
Fondi për Pakica	Jo	Po	Jo	Jo	Po	Jo	Jo
Min. e Turizmit	Jo	Po	Jo	Jo	Po	Po	Jo
Ministria e Punëve të Brendshme	Jo	Po	Jo	Jo	Jo	Po	Jo
Eko-fond	Jo	Po	Po	Jo	Po	Po	Jo
TO Tivat	Jo	Po	Po	Jo	Po	Po	Jo

Duke analizuar të gjithë mekanizmat e përmendur të shpërndarjes së mjeteve për organizatat joqeveritare, është e mundur të krahasohen sistemet në bazë të një sërë elementesh themelore, sipas të cilave mund të përcaktohen karakteristikat, cilësia dhe transparenca e sistemit të shpërndarjes së fondeve në nivel të rregullave ligjore. Elementet themelore mbi bazën e të cilave mund të vlerësohet një konkurs janë:

- mundësia e pjesëmarrjes së publikut në procesin e përcaktimit të prioriteteve të financimit,
- detyrimi për krijimin e komisionit për shpërndarjen e mjeteve,
- mundësia për korrigjimin e parregullsive në aplikim,
- vlerësimi i jashtëm i propozimeve të projekteve/aplikimeve,
- detyrimi për publikimin e listave të renditjes,
- detyrimi i përcaktuar për monitorim, dhe
- detyrimi për kryerjen e evaluimit të projekteve.

Gjatë mbledhjes së të dhënave për këtë tabelë, është marrë parasysh përmbajtja e akteve rregullative (ligjit, aktit nënligjor ose aktit të brendshëm) që përcakton kushtet për konkursin/thirrjen, si dhe vetë teksti i konkursit/thirrjes.

Ky krahasim nuk duhet domosdoshmërisht të paragjykojë rezultatet në praktikë, përkatësisht cilësia e rregullave ligjore nuk nënkupton automatikisht edhe cilësinë e zbatimit të dispozitave. Megjithatë, një proces vendimmarrës i rregulluar në mënyrë cilësore për shpërndarjen e mjeteve paraqet një mundësi për të siguruar mekanizma për parandalimin e konfliktit të interesit, marrjen e vendimeve të paanshme mbi bazën e fakteve dhe mendimeve profesionale, si dhe arritjen e efekteve afatgjata në fushën tematike ku shpërndahen mjetet.

Përmes zbatimit të parimeve të qeverisjes së mirë, menaxhimit të ciklit të projektit, qasjes së kornizës logjike dhe qasjes pjesëmarrëse, rritet cilësia, qëndrueshmëria afatgjatë dhe ndikimi i financimit publik në këto fusha.

Ndër indikatorët e veçuar në tabelën 2, duhet të theksohen dy rregulla: asnjë nga fondet e përmendura nuk përfshin mundësinë që publiku të marrë pjesë në përcaktimin e prioriteteve dhe modaliteteve të financimit të projekteve/programeve/aktiviteteve, si dhe as vlerësimin afatmesëm apo afatgjatë të ndikimit të shpërndarjes së mjeteve dhe të vetë projekteve.

Konsultimet mbi mënyrën dhe prioritetet e shpërndarjes së mjeteve janë një praktikë që prej shumë vitesh zbatohet nga Bashkimi Evropian, i cili detyrimisht konsulton si shtetet anëtare dhe përfituese të fondeve, ashtu edhe përfituesit e drejtpërdrejtë, siç është shoqëria civile. Mali i Zi, përmes Ligjit për OJQ-të në vitin 2017, ka përcaktuar detyrimin për zhvillimin e konsultimeve mbi analizën sektoriale, duke u mundësuar organizatave të kontribuojnë drejtpërdrejt në përshtatjen në kohë të mjeteve me sfidat në terren.

Gjithashtu, asnjë nga konkursat ose aktet shoqëruese nuk përcakton vlerësimin afatmesëm ose afatgjatë të ndikimit të shpërndarjes së mjeteve dhe as të vetë projekteve. Në këtë mënyrë do të sigurohej një pasqyrë mbi qëndrueshmërinë e zgjidhjeve dhe efektet e arritura përmes financimit, ndërsa raportet e vlerësimit do të përbënin një bazë cilësore për përmirësimin e shpërndarjes së mjeteve në ciklet e ardhshme.

PËRFUNDIME & REKOMANDIME

Një pjesë e konsiderueshme e projekteve përmes konkurseve të analizuara, edhe pse vetëm njëri prej tyre është shpallur ekskluzivisht për OJQ-të, përmban një përqindje të konsiderueshme të projekteve të organizatave joqeveritare. Ky fakt tregon për konkurrueshmërinë e organizatave joqeveritare kur bëhet fjalë për aplikimin në kushte të barabarta me persona të tjerë fizikë dhe juridikë.

Qasja në informacionet mbi mundësitë për financim në një vend të vetëm paraqet një sfidë për të gjithë aplikantët, përfshirë edhe organizatat joqeveritare. Është e nevojshme që informacionet për të gjitha konkurset të bashkohen dhe të publikohen në një vend të vetëm.

Është e nevojshme të digjitalizohen të gjitha aspektet e konkurseve: nga informimi i përmbledhur, aplikimi, publikimi i vendimeve për shpërndarjen e mjeteve, deri te raportimi. Të dhënat duhet të publikohen në format të hapur dhe të ndërveprueshëm, në mënyrë që të jetë më e lehtë të ndiqen rrjedhat e financimit.

Duke pasur parasysh se çdo organ udhëhiqet nga rregullat e veta për shpalljen e konkurseve, monitorimin dhe evaluimin e tyre, është e nevojshme të bëhet rishikimi i të gjitha rregulloreve për të siguruar cilësinë e zbatimit të të gjitha konkurseve.

Është e nevojshme të zhvillohet në mënyrë periodike procesi i evaluimit, si të suksesit të secilit program të veçantë të shpërndarjes së mjeteve për projekte (OJQ), ashtu edhe të ndikimit të përgjithshëm të financimit të organizatave joqeveritare nga të gjitha fondet publike në nivel lokal dhe shtetëror.

RRETH PROGRAMIT

Programi “Rrjeti i Qendrave të Burimeve të Malit të Zi” zbatohet me mbështetjen e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal-Investues dhe Bashkëpunimit me Organizatat Joqeveritare, me qëllim forcimin e kapaciteteve të organizatave joqeveritare dhe përmirësimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile në Mal të Zi.

Programi realizohet përmes Qendrës Kombëtare të Burimeve, të udhëhequr nga Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare (CRNVO), si dhe rrjetit të tre qendrave rajonale të burimeve dhe tre zyrave lokale.

Qendrat rajonale të burimeve janë:

- Qendra Demokratike e Bijello Poles – për rajonin verior;
- Horizonti i Ri (Ulqin) – për rajonin jugor;
- Zona Aktive (Nikshiq) – për rajonin qendror.

Zyrat lokale funksionojnë në:

- OJQ Bonum – Plav;
- OJQ Natura – Kotor;
- OJQ Nada – Herceg Novi.

Qëllimi i programit është të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për organizatat joqeveritare, grupet joformale të qytetarëve dhe institucionet publike, përmes:

- ofrimit të informacionit dhe këshillimit;
- asistencës juridike dhe teknike;
- ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve dhe mentorimit;
- mbështetjes në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve;
- promovimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave joqeveritare në proceset e vendimmarrjes;
- zhvillimit të bashkëpunimit ndërmjet sektorit civil dhe institucioneve publike;
- nxitjes së transparencës, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë.

Përmes rrjetit të qendrave të burimeve, organizatat joqeveritare në të gjitha rajonet e Malit të Zi kanë qasje në shërbime profesionale, mbështetje për zhvillimin organizativ dhe mundësi për përfshirje më aktive në proceset e hartimit të politikave publike dhe zhvillimit të komuniteteve lokale.

KE NDONJË PYETJE?

+ 382 20 219 860



crnvo@crnvo.me



<https://crnvo.me/>

